



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË**

VENDIM

Nr 87 Datë 10/10/2008

PËR

**NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMI TË MATERIALEVE TË
INVENTARIT EKONOMIK DHE ATIJ TË PAISJEVE**

Këshilli i Bashkisë së Qytetit Korçë, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Komisioni i Inventarizimit dhe Drejtoria e Qendres se Zhvillimit Rezidencial për "Nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit ekonomik dhe atij të pajisjeve, në zbatim të Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore", neni 32 pika e), Ligjit nr. 6492, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare" V.K.M. nr. 70, datë 11.03.1985 "Për administrimin, ruajtjen dokumentimin, dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare", si dhe mbas diskutimeve të Këshilltarëve:

VENDOSI :

1. Të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve sipas llogarive të mëposhtme:
 - a. Inventari ekonomik 392250 lek (Treqind e nentedhjet e dy mijë e dyqind e pesedhjet) lekë.
 - b. Inventari i paisjeve 387350 lek (treqind e tetedhjet e shtate mijë e treqind e pesedhjet) lekë .
2. Materialet të cilat do të nxirren jashtë përdorimit janë të pasqyruara në proces verbalet bashkangjitur këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Qendres se Zhvillimit Rezidencial Korce.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Raimonda Nase
RAIMONDA NASE